



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborna komisija za žalbe i molbe*

**A nr. 156/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Znj. Hateme Gashi në cilësinë e kandidates për këshilltare të kuvendit komunal, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë, që ka të bëjë me certifikimin e rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 04.05.2010, mori këtë:

### **VENDIM**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### **ARSYETIMI**

Znj. Hateme Gashi, kandidate për asamble komunale nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Pejë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se me rastin e publikimit në web-faqe të listës përfundimtare të kandidatëve për këshilltar komunal të Pejës ka pasur numrin e njejtë të votave me kandidaten Znj. Shpresa Luka gjithsej 79 vota.

Ndërsa me rastin e certifikimit kandidatja me nr. 18 Znj. Shpresa Luka është certifikuar nga ana e KQZ-së, ku sipas parashtrueses së ankesës KQZ nuk iu ka përmbajtur asnjë kriteri për certifikim të kandidatëve me vota të barabarta dhe duke bërë shkeljen e LZP-së.

### **FAKTET**

Më 16 prill 2010, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë nga Znj. Hateme Gashi, kandidate për asamble komunale nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Pejë.

Parashtruesja e ankesës ka ofruar formularët e KKZ-së si provë në lidhje me kryesin e supozuar të shkeljes së pretenduar.

## ANALIZË

Jurisdiksiioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Neni 106.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Rezultatet Zgjedhore) përcakton:

*106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.*

Meqenëse KQZ ka bërë certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për 36 Kuvendet Komunale të Republikës së Kosovës më datë 14 Dhjetor 2009 në ora 18:45, rezultatet janë përfundimtare dhe detyruese. Prandaj, ankese refuzohet si e pabazuar.

Për këtë arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

A nr. 156/2010 më datën 04.05.2010.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

